

AA

Vjetar informativ i
Departamentit të Antropologjisë
Fakulteti Filozofik,
Universiteti i Prishtinës
Shtator 2024 / Nr. 6



Nga 19 deri 22 shtator 2024, në Departamentin e Antropologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës, u mbajt konferenca e 11-të e InASEA-s. Më shumë se 100 studiues nga vende të ndryshme të Evropës prezantuan studimet e tyre në Prishtinë. Tema e konferencës:
“In, out and in between. Transnational and internal migration in Southeast Europe.”

Letra e redaksisë

Të dashur lexues,

Me këtë edicion të gjashtë të vjetarit nga Departamenti i Antropologjisë të Universitetit të Prishtinës synojmë të ju informojmë mbi punën, ngjarjet dhe bashkpunimet më të reja të Departamentit të Antropologjisë. Viti 2024 na priu me të reja, si në aspektin e krijimit të muzeve e mbajtjes së konferencave ndërkombëtare, ashtu edhe në themelimin e institucioneve të reja.

Ky vit korri frytin e punës së palodhshme katër vjeçare të profesorëve duke sjellur formimin dhe mishërimin e Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe përcjell me botimin e 10 vëllimeve të: “Kujtesa e Kosovës: rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe”. Si gjithmonë mbështetja dhe bashkëpunimi me ambasadën Amerikane në Kosovë nuk ka munguar as këtë vit duke kulminuar me themelimin e “Institutit të Antropologjisë” që shpresojmë të sigurojë avancimin e hulumtimit antropologjik në Kosovë.

Këtë vit Shkolla Verore e Antropologjisë na dërgoi në Ferizaj. U bë një hap para drejt krijimit të një modeli të ri të bashkëpunimit, që do mund të përdoret nga tash mes

Departamentit tonë dhe komunave anë e mbanë Kosovës. Rezultati i kësaj pune u materializua në formulimin e një raporti të detajuar për mënyrën e duhur të kultivimit të marrëdhënies në mes të qytetarit dhe muzeut. Ky lloj bashkëpunimi është një dëshmi e mirë e praktikabilitetit të punës antropologjike në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Shtatori mbledhi në Fakultetin Filozofik shumë antropologë e studiues të tjerë të shkencave shoqërore, duke na bërë krenarë të jemi nikoqir të konferencës së 11-të të InASEA me temë migrimin. Në fund të konferencës nuk munguan fjalë miradie në mesin e të cilave jehoi më së shumti ajo se kjo konferencë ishte një ndër tre më të mirat të InASEA-s.

Siç edhe do tradita e Departamentit të Antropologjisë, festivalet, puna në terren dhe vizitat e ndryshme sollën jo vetëm krijimin e përvojave të përbashkëta, por edhe dije të reja në mesin e studentëve. Po ashtu këtë vit nuk munguan bursat dhe shkëmbimet përmes ERASMUS-it për studentët tanë, duke i vendosur

ata në të njëjtin nivel si homologët e tyre evropianë.

Gjithmonë në explorim të mënyrave të reja të të ecurit para, me këtë vjetar shpresojmë jo vetëm të dokumentojmë zhvillimet tona dhe t’ju informojmë për to, por edhe të nxisim tek lexuesi një qasje proaktive dhe dashamirëse ndaj trashëgimisë kulturore në Kosovë.

Urojmë t’ju pëlqej!

Edena Zeqaj

Redaktore, studente e vitit të tretë

AA, Nr. 6, Shtatori, 2024

Vjetar informativ i Departamentit të Antropologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Redaktore: Edena Zeqaj (edena.zeqaj@studenti.uni-pr.edu) (studente)

Del njëherë në vit, në formë të shtypur dhe digjitale.

Ballina © - uebfaqja: <http://filozofiku.uni-pr.edu/Departamentet/Departamentio9.aspx>



INFO & AKTIVITETE

MA në Trashëgimi kulturore

Këtë vit, Departamenti i Antropologjisë ka punuar intensivisht në aplikacion për akreditim të programit të shumëpritur MA Trashëgimi kulturore. Programi është disenuar duke marrë parasysh nevojat e studentëve, ish-studentëve, punëdhënësve, tregut e me radhë. Po ashtu, diskutime të shumta janë realizuar edhe me këta hisedarë për të krijuar një program përkatës, të veçantë dhe që përmbush nevojat profesionale për studimin e trashëgimisë kulturore.

Në rast akreditimi, programi do të fillojë në shtator të vitit 2025.

Doktoron Ass. Ilir Culaj

Departamenti i Antropologjisë tani ka një doktor të ri të shkencave. Në prill të vitit 2024, kolegu ynë, asistenti Ilir Culaj ka mbrojtur me sukses temën e doktoratës për shkencat e antikitetit dhe arkeologjisë në Universitetin Paris Science Lettre, i cili është në top 40 universitetet më të mira në botë.



Themelohet Instituti i Antropologjisë



iaup

Në vitin 2023-2024, Departamenti i Antropologjisë ka qenë përfitues i grantit University Support Grant të financuar nga Ambasada e SHBA-ve në Kosovë, dhe administruar nga KUSA - Kosovo United States Alumni, për themelimin e Institutit të Antropologjisë.

Instituti i Antropologjisë është themeluar në përputhje me rregulloret dhe Statutin e UP-së dhe me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare. Po ashtu, Instituti do të synojë bashkëpunimin me institute e institucione të ndryshme ndërkombëtare për avancimin e hulumtimit antropologjik në Kosovë.

Prof. Arsim Canolli është udhëheqës i këtij projekti, që realizohet në bashkëpunim me kolegë të Departamentit. Përmes këtij granti është përpiluar dokumentacioni i institutit, përfshirë politikat kërkimore, strategjia e zhvillimit, udhëzimet e standardet profesionale, identiteti vizuel e promovues i Institutit, prezenca online, etj. Instituti ka zyrën (08) në Fakultetin Filozofik, në katin përdhësë.

Hapja inaguruese e IAUP-së do të bëhet me 3 tetor 2024.

Bursa për “alumni”

Në vitin 2024, 12 ish-studentë të Departamentit të Antropologjisë, në drejtimet arkeologji dhe antropologji kulturore, kanë fituar bursa nga MKRS për të studiuar në nivelin MA dhe PHD nëpër universitete prestigjioze evropiane, përfshirë Universitetin e Oksfordit dhe EPHE në Paris. Që nga vitit 2016, Ministria e Kulturë, pandërprerë ka ofruar bursa për studime postdiplomike për studentë të antropologjisë dhe arkeologjisë. Për këtë, Departamenti i Antropologjisë është falënderues dhe mirënjohës.

Pullë postale për Edi Shukriun

Në fund të vitit 2023, Posta e Kosovës e ka lëshuar në qarkullim një pullë postare dedikuar Edi Shukriut, arkeologes së parë në Kosovë. Profesoresha Edi Shukriu ishte themeluese e programit të arkeologjisë në Departamentin e Antropologjisë, ku edhe u pensionua. Ajo vdiq më 17 janar 2023. Edi Shukriu ka lindur në Prizren më 22 tetor 1950. Në vitet ‘70-të studioi për arkeologji në Universitetin e Beogradit, ku edhe magjistroi. Ka punuar në Muzeun e Kosovës, ndërkaq bëri karrierë akademike në Universitetin e Prishtinës dhe në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve e Kosovës. Në periudhën mes viteve 2009 - 2012, Edi Shukriu ishte Kryetare e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Edi Shukriu ishte edhe shkrimtare dhe aktiviste politike. Ajo botoi shtatë vepra me poezi, tre drama dhe një roman. Ka qenë deputet e Kuvendit të Kosovës në legjislaturën e parë pas luftës.

KOSOVA ANTHROPOLOGICA

1 - 2023

KDU 316.2(496.51)(05)
ISSN 3027-5024 (Online)

Botohet numri i parë i revistës Kosova Anthropologica

Në Dhjetor 2023, Departamenti i Antropologjisë ka botuar numrin e parë (online, në shtyp, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze) të revistës “Kosova Anthropologica” – revistë shkencore e Departamentit të Antropologjisë.

Revista synon të botojë studime të reja dhe specifike nga hulumtues të fushës së antropologjisë – si nga ata të rinj ashtu edhe nga hulumtues me përvojë. Antropologjia shqiptare është pluraliste dhe synon të rivitalizojnë fushën e studimeve albanologjike mbi gjuhën, kulturën dhe historinë e shqiptarëve me metoda e qasje të reja.

Revista mund të lexohet këtu:
www.kosovaanthropologica.com

IKMEK 2024



Në pranverë të vitit 2024, Departamenti i Antropologjisë ka filluar projektin “Identiteti kulturor i minoriteteve etnike në Kosovë: studim antropologjik”. Ekipin hulumtues e udhëheq Prof. Arsi Canolli, ndërsa bashkëpunëtorë janë prof. Tahir Latifi dhe prof. Zanita Halimi, së bashku me studentët Valmira Rashiti dhe Rilinda Gjonbalaj. Projekti do të zgjas deri në fund të vitit 2024, me mundësi vazhdimi deri në qershor 2025.

Ky projekt i mbështetur nga Universiteti i Prishtinës synon të hulumtojë format e identifikimit, shprehjet kulturore dhe manifestimet e identitetit kulturor,

social e politik të tri komuniteteve të vogla dhe më pak të studiuara të Kosovës, përkatësisht, të goranëve, boshnjakëve dhe kroatëve. Hulumtimi i jetesës së këtyre komuniteteve në Kosovë është parë si nevojë, meqenëse ata shpesh cilësohen si komunitete “të heshtura”, “të përziera”, apo “të dyfishta”. Si për goranët e Gorës, në zonën e Prizrenit, ashtu edhe për boshnjakët e Zhupës, po ashtu afër Prizrenit, ekzistojnë stereotipizime, keqkuptime dhe interpretime hamendësuese për origjinën, kulturën, identitetin dhe integritetin e tyre si komunitet përbërës i mozaikut etnik të

Kosovës. Në të njëjtën mënyrë, identifikohen edhe kroatët e Janjevës dhe Letnicës së Vitisë.

Për të kuptuar më mirë këto aspekte të kontestuara të jetës së këtyre komuniteteve, ekipi hulumtues ka realizuar intervista, vrojtime të dasmave e ritualeve dhe diskutime me anëtarë të këtyre komuniteteve gjatë muajve prill - shtator 2024.

Rezultatet kryesore të projektit do të jenë shkrime antropologjike të botuara në revista ndërkombëtare dhe vendore.

Prof. Arsim Canolli dhe prof. Arben Hajdari vlerësohen nga UP për punën e tyre kërkimore

Në përvjetorin e themelimit, më 15 janar 2024, Universiteti i Prishtinës nderoi dhe vlerësoi kontributin e stafit akademik, për punën e vyer kërkimore dhe ngritjen e profilit akademik të universitetit.



Prof. Arben Hajdari zgjedhet anëtar korrespondent i AOROC, Francë

Në shkurt të vitit 2024, Prof. Arben Hajdari, është zgjedhur anëtar korrespondent i Institutit prestigjioz në Paris - Archéologie & Philologie d'Orient et d'Occident (AOROC).

Ky sukses individual i prof. Hajdarit, padyshim që është po ashtu sukses i Universiteti të Prishtinës, veçanërisht Departamentit të Antropologjisë. Instituti merret me hulumtime arkeologjike dhe filologjike, ai funksionon në kuadër të Qendrës Nacionale për Kërkime Shkencore (CNRS) dhe Universitetit Paris Science Lettre (PSL). Aktualisht ky Institut udhëheq 25 projekte (misione) arkeologjike në shumë vende të botës, si Francë, Itali, Egjipt, Turqi etj.

Ndërsa në fushën e filologjisë, Instituti është një nga bartësit kryesorë në hulumtimet e letërsisë klasike. Ato përfaqësojnë sidomos studimet e autorëve grekë si Euripidi, Demosteni, Aristoteli dhe Straboni, kurse në latinisht, ato të Horacit, Lukanit, Plinit të Vjetër etj. Në rrafshin e studimeve filologjike, historike dhe arkeologjike, AOROC vazhdon gjithashtu botimin e korpuseve të rëndësishme epigrafike, në gjuhë të ndryshme si Linear A, gjuhë italike para-romake dhe latine.



Veshjet popullore të Kosovës

Çfarë ka mbetur ende në arkat e Kosovës? Sa kanë ndryshuar motivet qendisësore në veshjet shqiptare? Ku dallojnë veshjet e shqiptarëve me veshjet tjera? Si dallojnë veshjet e krahinave të Kosovës? Çfarë veshjesh kanë kroatët e Kosovës? Pse veshja e katunit (në Dukagjin) qenka “bardh e zi” e veshjet tjera “plot ngjyra”? Sa dhe si po transformohet, komercializohet, trashëgimizohet veshja popullore? Çfarë po ndodhë me mirëmbajtjen, riprodhimin, veshjen, shpikjen e falsitetin e veshjeve? Çfarë po ndodh me “të kaluarën në të tashmen”? - e shumë tema të tjera.

Më 6 dhjetor 2023, në Departamentin e Antropologjisë u prezantua hulumtimi i Arbnora Kolgjerajt, alumni e Departamentit, e cila ka bashkëpunuar me prof. Arsim Canolli, (mentor i projektit) dhe studentet e Departamentit, Rilinda Gjonbalaj dhe Miridona Sylaj, për të gjurmuar veshjet popullore anekënd Kosovës. Gjatë prezantimit u shpalosë se janë shprehur mbi 7000 fotografi, janë vizituar mbi 100 familje, muze, koleksione private e ansamble dhe janë bërë intervista e hulumtime në të gjitha cepat e Kosovës.

Departamenti i Antropologjisë bashkëpunon ngushtë me ish-studentët (alumni) dhe me studentët e tyre në projekte hulumtuese konkrete mbi kulturën, sjelljen dhe trashëgiminë kulturore.

Çmimi “Pena e Shtjefën Gjeçovit” për prof. Arben Hajdarin nga “Takimet e Gjeçovit”

Më 28 tetor 2023, prof. Arben Hajdarit iu nda çmimi “Pena e Shtjefën Gjeçovit” në manifestimin tradicional “Takimet e Gjeçovit” për kontributin e tij në fushën e arkeologjisë. Këto takime organizohen që nga viti 1972, dhe njihen si ndër aktivitetet më të vjetra të organizuara në Kosovë.

Duke falënderuar organizatorin, prof. Hajdari theksoi rëndësinë e manifestimit “Takimet e Gjeçovit”, dedikuar veprës së At Shtjefën Gjeçovit, i cili njihet edhe si arkeologu i parë, por edhe rëndësinë e ruajtjes së bashkëpunimit mes organizatave të tilla joqeveritare dhe Departamentit të Antropologjisë, në Universitetin e Prishtinës.

Ambasadori amerikan z. Jeffrey Hovenier dha ligjëratë mysafire në Departamentin e Antropologjisë



Më 10 tetor, në Departamentin e Antropologjisë dha një ligjëratë ambasadori i SHBA-ve, shkëlqesia e tij, z. Jeffrey Hovenier. Ai rrëfeu përvojën e tij si student i antropologjisë, në rininë e tij, në Bolivi e vende të tjera. Po ashtu, ambasadori foli për rëndësinë e antropologjisë në studimin e kulturës, diversitetit kulturor e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Ambasadori iu përgjigj pyetjeve të studentëve dhe pati diskutim të hapur me ta, sidomos për vlerësimin e njohjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës.

“Akordet e Kosovës” – prezantim nga studentët Enis Bytyqi dhe Tringa Sefedini në konferencën “Prishtina Music Conference”



Më 3 nëntor 2023, në kuadër të “Prishtina Music Conference” [Konferenca e Muzikës e Prishtinës] studentët e vitit të tretë të Departamentit të Antropologjisë, Enis Bytyqi dhe Tringa Sefedini, shpalosën punën e tyre në digjitalizimin e arkivit të festivalit “Akordet e Kosovës”, në një panel diskutimi nën titullin “*Preserving music, then and now – with Festakordet*” [Ruajtja e muzikës, atëherë dhe sot – me Festakordet]

Në fillim të këtij viti, Enisi dhe Tringa kishin mbledhur dëshmi si: dokumente, rrëfime, materiale arkivore e shumëçka tjetër dhe i kishin vendosur në uebfaqen www.festakordet.com.

Ky dokumentimi këtij arkivi paraqitet si pikënisje për studimin e kësaj trashëgimie muzikore në Kosovë. Duke filluar nga vitet 1960 e deri në vitet 1990, festivali “Akordet e Kosovës” ka shërbyer si skenë për artistët e kohës dhe si nxitës për krijimtarinë muzikore dhe kultivimin e shijes estetike në Kosovë.

Uebfaqja [festakordet.com](http://www.festakordet.com) na ofron një adresë për të mësuar e rikujtuar hollësitë mbi këtë ngjarje kulturore si historikun, strukturën, shpërblimet, fotografitë, kujtimet e librat e këtij festivali. Mbi të gjitha, ky arkiv i festivalit vjen si platformë për të gjurmuar festivalin, me shpresë që të mos harrohet kurrë.

Pjesëmarrja e Enist dhe Tringës në këtë konferencë vë në pah nevojën e ndërthurjes së antropologjisë, historisë dhe formave të reja vizuale e teknologjike, për të treguar rëndësinë e hulumtimeve dhe nismave të reja në ruajtjen e promovimin e trashëgimisë kulturore.

Simpoziumi Ndërkombëtar mbi Trashëgiminë Kulturore, Bolonja

Profesori Arsim Canolli ka marrë pjesë në sesionin e nivelit të lartë “Interpretimet e vlerave të trashëgimisë në dritën e 20-vjetorit të Konventës së UNESCO-s për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore” të Simpoziumit Ndërkombëtar mbi Trashëgiminë Kulturore “*Trashëgimia kulturore materiale dhe shpirtërore përmes së kaluarës, së tanishmes dhe në të ardhmen*” me fokus në “UNESCOPIA: mbledhja dhe krijimi i trashëgimisë në Kosovë”, i mbajtur në Forlì dhe Bertinoro më 18 dhe 19 janar 2024, në Universitetin e Bolonjës, në Itali.

Simpoziumi, i organizuar nga Universiteti i Bolonjës, Universiteti McGill dhe Universiteti i Pizës, në bashkëpunim me Universitetin Sapienza të Romës, Universitetin e Misisipit, Universitetin Palacký të Olomouc dhe Rrjetin e Universiteteve për Fëmijët dhe Konfliktet e Armatosura, qëndron si një platformë ndërkombëtare për diskutime të thella mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore në jetët tona, me synimin për të hapur rrugën për qasje gjithëpërfshirëse në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë.

Objektivi i Simpoziumit ishte që të rivlerësohen konceptet e materialitetit dhe jomaterialitetit dhe të propozohen metoda të reja për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë, gjithashtu përmes teknologjive digjitale, gjatë kohës së luftës dhe paqes, për të garantuar paqen dhe sigurinë



ndërkombëtare, të drejtat e njeriut dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Në këtë simpozium u themelua edhe *Instituti Ndërkombëtar i Trashëgimisë* (International Heritage Institute), ku profesor Canolli u përzgjodh anëtar i bordit akademik.

Ekspedita studentore e Departamentit

Ilir Culaj


Përgjatë katër ditëve, në qershor 2024, një grup i studentëve nga Departamenti ynë, së bashku me disa profesorë, vizituan Shqipërinë. Fokusi i vizitave këtë vit ishin lokalitetet arkeologjike, ku përveç mësimave arkeologjike, spjegimet dhe debati u orientuan sidomos nga prespektiva antropologjike në studimin e njeriut në lashtësi.

Ditën e parë e kaluam në Apolloninë e Ilirisë, qytetin ku jetoi për një kohë edhe Augusti i famshëm. Patëm nderin që për këtë qytet kaq të rëndësishëm të na spjigonte kolegu ynë, prof. Lavdosh Jaupaj, të cilin e falenderojmë shumë.

Të nesërmen vizituam qytetin ilir të Amantias, ku gjetëm duke gërmuar kolegun tonë arkeolog, prof. Kriledjan Çipa, i cili na e bëri një spjegim të detajuar mbi lokalitetin. Stadiumi antik i qytetit ishte madhështor përballë maleve të larta, poshtë të cilave gjarpëronte lumi Vjosa. Pasdite ishim tek Muzeu i Pavarësisë.

Pas dy netëve të kaluara në Aulona, u nisëm për në Sarandë. Fillimisht, gjatë rrugës vizituam Bylisin - qytet ilir me rreth 30 hektarë sipërfaqe. Spikatnin muri rrethues, teatri dhe bazilikat e shumëta. Pastaj vizituam Butrintin, ku profesor Gjergj Vinjahu u kujdes që përmes spjegimit të tij, të mos i hiqte asnjë copë madhështie këtij qyteti.

Falenderojmë kolegët tanë nga Shqipëria për shoqërimin dhe shpjegimet e tyre të vyera. Po ashtu, falenderojmë studentët tanë për angazhimin e tyre përmes pyetjeve e komenteve të shumta, dhe për reflektimet mbi rëndësinë e ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore



Simfonia e zemrës

Një udhëtim në vendet e lashta

Gëzim Thaqi

Ekskursionet dhe udhëtimet luajnë një rol vendimtar në jetën akademike të studentëve. Ato ofrojnë një mundësi unike për të vënë në praktikë njohuritë teorike të klasës dhe për të fituar një kuptim më të thellë të fushës së studimit. Këto përvoja janë të pasura për rritjen personale dhe akademike, duke zhvilluar aftësi dhe kompetenca të vlefshme për karrierën e ardhshme. Pjesëmarrja në këtë udhëtim më ndihmoi të kuptoj rëndësinë e studimeve të mia në antropologji dhe arkeologji, duke forcuar pasionin për këto fusha.

Udhëtimi ynë filloi nga Prishtina drejt Shqipërisë, falë shoferit tonë të besueshëm Edi, i cili na siguroi një udhëtim të sigurt dhe komod. Destinacioni i parë ishte Apollonia, një vend arkeologjik në jug të Shqipërisë, i njohur për trashëgiminë e tij historike dhe kulturore nga periudha antike deri në atë romake. Vizita në Apolloni ishte magjepsëse, sepse më dha mundësinë të përjetoj historinë dhe kulturën e këtij vendi të mrekullueshëm. Pas kësaj, udhëtuam drejt Vlorës, ku qëndruam në një hotel të bukur buzë detit. Ky moment pushimi dhe freskimi ishte një shpërblim i merituar pas udhëtimit të gjatë dhe intensiv.

Në Vlorë, studentët u afruan më shumë, duke ndarë gëzimet dhe nevojat e përbashkëta, dhe kështu filloi një lidhje e ngrohtë miqësore mes nesh. Darka në hotel ishte e shijshme, me ushqim rajonal të shkëlqyeshëm, që na ofroi një përvojë kulinare të pasur dhe autentike. Mëngjesin e së nesërme e kaluam së bashku dhe u bëmë gati për të vizituar qytetin antik Amantia. Para nisjes, pata pak kohë për të notuar në det, një freskim i mirëpritur për të filluar ditën.



Udhëtimi drejt Amantias ishte i mbushur me pamje natyrore të mahnitshme, duke më dhënë një ndjenjë sigurie dhe kënaqësie për atë që po përjetoja. Vizita në Amantia ishte mbresëlënëse, një qytet i lashtë me pasuri të veçanta dhe potencial të madh për t'u bërë një atraksion turistik i rëndësishëm. Profesor Culaj na ofroi një udhëzim të detajuar dhe të pasur me njohuri historike, për të cilin jam shumë mirënjohës dhe dua ta falemindëroj shumë. Gjatë këtij udhëtimi, mësova shumë dhe u ndjeva i privilegjuar që isha pjesë e kësaj përvoje.

Pas kthimit në Vlorë, ndaluan për darkë në Shpellën e Vajzës, një restorant i shkëlqyer, dhe më pas vizituan shtëpinë e pavarësisë në Vlorë. Kjo vizitë ishte domosdoshmëri për të rikujtuar kohërat themeluese të kombit shqiptar. Në zyrën e Ismail Qemalit, pashë disa libra të tij që ishin të ruajtur në një komodë. Gjithashtu, ora e vjetër që kishte ndaluar në orën katër ishte shumë

mistike, duke shënuar momentin e shpalljes së pavarësisë dhe ngritjes së flamurit kombëtar. Diskutimet mbi këtë fenomen mes studentëve ishin interesante.

Të nesërmen udhëtuam për në Bylis, një nga vizitat më mbresëlënëse për mua. Madhështia e këtij qyteti antik ilir ishte befasuese. Pozita strategjike dhe mbijetimet arkeologjike ishin të jashtëzakonshme. Bukuritë natyrore të këtij vendi krijuan një lidhje të thellë shpirtërore tek unë. Ndërsa ecja nëpër rrënojat e Bylisit, ndjeja një lidhje të veçantë me të kaluarën dhe historinë e këtij vendi. Ishte një përvojë që më mbushi me emocion dhe admirim.

Pas vizitës në Bylis, udhëtuam për në Butrint, la grande finale! Butrinti është një ndër qytetet antike më të vizituara të Shqipërisë, me rreth 400,000 vizitorë në vit. Kjo vizitë ishte shumë informative, falë arkeologut Gjergji, i cili na shpjegoi me detaje historinë dhe funksionet e ndryshme të qytetit gjatë periudhave. Butrinti



dallohet nga qytetet e tjera për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tij të shkëlqyer. Kjo vizitë ishte shumë informuese dhe ndihmoi secilin nga ne të mësojmë më shumë për arkeologjinë në terren.

Pas përjetimit të Butrintit, udhëtuam për në Sarandë. Mbërritja në Sarandë ishte e suksesshme, përveç një keqkuptimi të vogël në recepsionin e hotelit. Pas një pushimi të shkurtër, vazhduam së bashku për të darkuar dhe për të përfunduar mbrëmjen me diskutime në qytetin e Sarandës. Kjo mbrëmje ishte një mundësi e shkëlqyer për të reflektuar mbi përvojat tona dhe për të forcuar lidhjet mes nesh.

Të nesërmen, pas një nate të qetë, udhëtuam për të vizituar Gjirokastrën, destinacionin e fundit të ekskursionit tonë. Gjirokastra

është një qytet i bukur dhe idilik, që mbush çdo vizitor me dashuri për këtë vend. Këtu kaluam një kohë të mrekullueshme duke ecur në rrugicat e qytetit dhe duke diskutuar me banorët lokalë. Një moment i veçantë ishte takimi me një banorë të një shtëpie aris-tokrate, e cila na tregoi për historinë dhe kulturën e qytetit. Gjithashtu, pata mundësinë të diskutoj me një plakë që shiste gdhendje në gur të punuara nga djali i saj. Kjo zonjë më mbajti në mendje nga një vizitë e mëparshme dhe më dha një ndjenjë ngrohtësie dhe mirëseardhjeje.

Pas vizitës në Gjirokastrë, u kthyen në autobus dhe udhëtuam drejt Prishtinës. Kthimi ishte i mbushur me muzikë të zgjedhur nga ne, duke na dhënë një ndjenjë të përzjerë gëzimi. Ky udhëtim ishte një përvojë

e veçantë dhe më dukej si fundi i një filmi që dëshiroja të vazhdonte. Kompetencat për të menaxhuar dhe drejtuar këtë udhëtim në një përvojë të shkëlqyer për studentët ishin falë profesorëve Latifi dhe Canolli. Ata na bënë të ndjehemi gjithmonë të sigurt dhe të barabartë.

Dua t'i falënderoj shumë profesorët dhe Universitetin e Prishtinës për këtë mundësi të mrekullueshme që do të më ndihmojë në studimet e mia të ardhshme. Shpresoj që të gjithë studentët e departamenteve të kenë një përvojë të tillë në degët e tyre. Ky udhëtim do të ketë gjithmonë një vend të veçantë në kujtesën time, i mbushur me momente të ngrohta, miqësi të reja dhe përvoja të çmuara. Jam thellësisht i dashuruar me këtë përvojë dhe me gjithë çfarë kam mësuar dhe përjetuar gjatë këtij udhëtimi të jashtëzakonshëm.

“Antropologjia kulturore”

UP përkrah botimin e librit universitar të prof. Arsim Canollit



Në Fakultetin Filozofik, më 16 shkurt 2024, u bë promovimi i librit të Prof.Asoc.Dr. Arsim Canolli – Antropologjia kulturore: hyrje e shkurtër.

Botimi i këtij libri paraqet një lajm të mirë për studiuesit dhe studentët e antropologjisë dhe shkencave sociale në përgjithësi. Ky libër është një kontribut i madh në rrafshin teorik, metodologjik dhe praktik, duke ofruar një qasje gjithëpërfshirëse, shpjegime dhe interpretime të thukëta për tema të rëndësishme në fushën e antropologjisë dhe shkencave sociale në përgjithësi. Pra, është një libër i duhur jo vetëm për antropologët, por edhe për studiues e studentë të fushave tjera, të sociologjisë, historisë, shkencës politike, filozofisë, linguistikës dhe letërsisë dhe të ngjashme.

Libri përmban parathënien dhe dhjetë kapituj, i ndarë në dy pjesë.

Pesë kapitujt e parë ofrojnë njohje për antropologjinë, për metodat, teorinë dhe qasjen antropologjike; fillet e disiplinës shkencore dhe prijtarët e antropologjisë si shkencë. Ndërsa pjesa e dytë, pesë kapitujt tjerë, trajtojnë temat që, sipas autorit, janë kyçe në antropologjinë kulturore.

I pranishëm në këtë promovim ishte edhe rektori i Universitetit të Prishtinës Prof.Dr. Qerim Qerimi, i cili përgëzoi autorin për botimin dhe Departamentin e Antropologjisë për punën e vyeshme ndër vite, duke inkurajuar që të vazhdohet tutje me punë të tilla. Edhe dekani i Fakulteti Filozofik, Prof.Asoc.Dr. Dashamir Bërxulli, shprehi urimet e veta duke potencuar rëndësinë e këtij botimi dhe duke konfirmuar mbështetjen për Departamentin e Antropologjisë.

Ky libër është botuar nga Universiteti i Prishtinës, njëherësh, kjo është hera e parë që UP ka filluar financimin e botimeve të librave universitarë.



Shpresojmë se viteve të ardhshme UP-ja të rrisë edhe më shumë buxhetin për financim të teksteve universitare.

Punëtorja GIS nga Erina

Më 18 qershor 2024, pata kënaqësinë të mbaja një punëtori të plotë mbi Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS) në Universitetin e Prishtinës. Punëtorja kishte për qëllim të prezantonte studentët me parimet bazë dhe aplikimet praktike të GIS në fusha të ndryshme, veçanërisht në arkeologji.

Punëtorja filloi me një përmbledhje të teknologjisë GIS, duke përfshirë historinë, figurat kyçe dhe mënyrat e shumta në të cilat mund të përdoret për të analizuar të dhëna hapësinore. Pjesëmarrësit u prezantuan me funksionalitetet bazë të ArcGIS, një softuer kryesor në këtë fushë. Pjesa e dytë e punëtorisë përbëhej nga ushtrime praktike, ku pjesëmarrësit mësuan si të krijojnë, manipulojnë dhe interpretojnë të dhëna hapësinore në ArcGIS online, duke u mundësuar atyre të krijojnë harta të thjeshta që mund të përdoren për punime shkencore dhe prezantime.

Një pjesë e rëndësishme e punëtorisë u fokusua në aplikimet praktike. Ne eksploruam studime të rasteve të rëndësishme për rajonin, duke përfshirë shfaqjen e të dhënave të anketave, analizën e modeleve të vendbanimeve, pamje vizuale (viewsheds), dhe analizën e rrugëve me koston më të ulët (LCP), për të përmendur disa.

Reagimet nga pjesëmarrësit ishin jashtëzakonisht pozitive. Pjesëmarrësit vlerësuan qasjen praktike dhe rëndësinë e studimeve të rasteve për interesat e tyre kërkimore. Në fund të punëtorisë, pjesëmarrësit kishin fituar jo vetëm një kuptim të mirëfilltë të bazave të GIS, por gjithashtu ndiheshin të fuqizuar për të aplikuar këto aftësi në përpjekjet e tyre akademike dhe profesionale. Kjo punëtori ishte një hap domethënës



në rritjen e njohurive gjeohapësinore në Universitetin e Prishtinës, duke nxitur një gjeneratë të re kërkuesish të pajisur me këtë aftësi të vlefshme teknologjike.

Donacion librash për Bibliotekën e Fakultetit Filozofik – UP



Profesori Gian Luca Gregori ka derguar rreth shtatë pako me libra, si donacion për Departamenti i Antropologjisë / UP, respektivisht Fakultetin Filozofik. Falënderojmë shumë profesorin ordinar nga Departamenti i Shkencave të Antikitetit në La Sapienza, Gian Luca Gregori, i cili dhuroi këta libra, të cilët do pasurojnë bibliotekën tonë. Këta tituj i takojnë kryesisht fushës së epigrafisë latine, arkeologjisë dhe historisë, të nevojshëm sidomos për studentët tanë arkeologë dhe historianë.

Falënderojmë ambasadorin e Republikës së Kosovës në Itali, Sh.S. znj. Lendita Haxhitasim për angazhimin dhe gatishmërinë për dërgesën e këtij donacioni në destinacion, përmes Ambasadaës së Kosovës në Itali dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diaspores.

Në koordinim me profesorin Gian Luca Gregori dhe ambasadorin Lendita Haxhitasim, po punojmë që së shpejti të avancojmë bashkëpunimin mes Departamentit të Antropologjisë UP dhe atij të Shkencave të Antikitetit në La Sapienza - Romë. Po ashtu, shprehim mirënjohje dhe falënderim edhe për Ambasadën e Italisë në Kosovë, e cila ka mbështetur në vazhdimësi avancimin e studimeve arkeologjike në Kosovë.

Kongresi ndërkombëtar i arkeologjisë klasike, Paris



Kongresi ndërkombëtar i arkeologjisë klasike (3-9 qershor) në Paris (XXe Congrès international d'archéologie classique, archéologie des espaces vécue) ku po marrin pjesë një numër i madh studiuesish nga e gjithë bota, të organizuar/shpërndarë në 43 sesione të ndryshme.

Në këtë Kongres, nga Kosova po marrin pjesë dy profesorë nga Departamenti i Antropologjisë, Arben Hajdari, anëtar i Këshillit Shkencor të Kongresit dhe organizator e drejtues i sesionit të 42 “*Les multiples vies des cités de la Méditerranée: topographie, urbanisme, espaces vécus*”, si dhe Arsim Canolli, i cili në këtë Kongres është paraqitur me temën “*Observing Acts of Discovery: An Ethnography of Archaeology in Kosova - the case of Ulpiana Archaeological Park*”.

Me këtë rast, nga Arsim Canolli është shfaqur edhe një film i shkurtër etnografik mbi gjetjen e mbishkrimit të Justinianit dhe Teodorës, kushtuar qytetit të Dardanisë,



Gratë dhe epigrafia latine në Dardani: rasti i Kosovës

Ilir Culaj

Në kuadër të një konference të organizuar nga Universiteti i « Grenoble Alpes », me temë : « De la peregrina à la clarissima : l'épigraphie au féminin » (24 maj, 2024), u diskutua mbi rolin dhe përfaqësimin e grave dhe vajzave në epigrafinë romake. Ky takim ndërkombëtar mbi gratë dhe epigrafinë bashkoi specialistë dhe studentë të doktoraturës nga një sërë universitetesh franceze dhe evropiane. Prezentimet më shumë trjatonin tema që preknin zonat e Italisë në antikitet, Spanjës e Galisë. Ndërsa për të dhënë një këndvështrim mbi gjendjen edhe në provincat lindore të Perandorisë Romake, prezentova rreth grave dhe epigrafisë latine në Dardani, me fokus Kosovën antike. Ndër të tjera, në kuadër të kësaj konference u diskutua rreth organizimit politik të Dardanisë, influencës romake dhe roli i epigrafisë në ndriçimin e aspekteve sociale të shoqërisë dardane.

Dardania shtrihej në Kosovën e sotme, veriperëndim të Republikës së Maqedonisë së Veriut, jugun e Serbisë dhe veriperëndimin e Shqipërisë. Qytetet kryesore të saj ishin Scupi, Ulpiana dhe Naissus. E vendosur në zemër të Ballkanit, mes Lindjes dhe Perëndimit, Dardania zinte një pozicion të favorshëm gjeografik dhe gjeostrategjik. Pas pushtimit romak, Dardania u bë pjesë e Mesisë së Epërme deri në sundimin e Dioklecianit, i cili i dha statusin

e provincës romake. Mbishkrimet e korpusit tonë epigrafik datojnë shumica mes shekujve II-IV, dhe janë dëshmia më e mirë e një procesi romanizimi që padyshim u vu re, por që nuk arriti asnjëherë të ishte dominues. Dardanët formuan një kulturë me karakteristika lokale, duke ruajtur aspektet e përbashkëta të kulturës ilire, familjes së cilës i përkisnin.

Me ndikimin romak, kemi një prani të madhe të mbishkrimeve latine në Dardani, të gjetura në pjesën më të madhe në territorin e Kosovës së sotme. Pavarësisht që gratë nuk luanin një rol aktiv në jetën politike dhe administrative, përmes këtij punimi paraqita disa shembuj të përfaqësimit të gruas në kontekstin lokal përmes epigrafisë. Falë informacioneve të marra nga epigrafia, arrijmë të shohim më shumë detaje mbi rolin e gruas në jetën shoqërore dhe statusin e saj. Duke analizuar disa nga përkushtimet religjioze të ngritura nga gratë, mund të kuptojmë më shumë për rolin e tyre në aspekte të ndryshme të jetës religjioze në Dardani. Mes tjerash, u trajtua edhe çështja e onomastikës së grave në Dardani, ku përmendem disa emra të konsideruar si iliro-dardan, dhe ndikimet e onomastike latine më pas. Pavarësisht vështirësive metodologjike, u interesuam edhe për origjinën etnike të grave të përfaqësuara në këto mbishkrime, si dhe rolin e tyre në procesin e romanizimit. Krejt në fund, u

përmend që korpusi i mbishkrimeve latine nga Kosova paraqet një mundësi shumë të mirë që të njihemi me aspekte sociale të banorëve të Dardanisë,



rrjedhimisht të na krijoj një pamje më të përgjithshme edhe mbi organizimin e pjesës lindore të Perandorisë Romake.

Projekte

Inaugurimi i Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe




Pas një punë 4 vjeçare, në 25 vjetorin e Masakrës së Krushës së madhe, më 26 mars 2024, u inauguroi Muzeu i Masakrës së Krushës së Madhe në Krushë të Madhe.

Konceptimi kuratorial dhe dizajni i ekspozitës muzeale u realizua në mënyrë vullnetare nga profesorë dhe studentë të Departamentit të Antropologjisë, profesorë dhe studentë nga Fakulteti i Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, aktivistë dhe banorë të Krushës, zyrtarë përgjegjës komunalë, përfaqësues të institucioneve (2023-2024).

Grupi punues, kuratorial përbëhet nga krushjanët, hulumtuesit/studentët dhe profesorët e Departamentit të Antropologjisë. Studentët nga Antropologjia dhe Sociologjia: Valentina Krasniqi, Ridona Berisha, Tringa Sefedini, Flaka Berisha dhe Çlirimtare Januzaj. Studentët nga Fakulteti

i Arkitekturës: Ari Nekoviqi, Ertur Salihaj, Ylljon Kurti dhe Alban Markaj. Profesorët nga Departamenti i Antropologjisë, Arsim Canolli dhe Tahir Latifi; profesorët nga Fakulteti i Arkitekturës, Florina Jerliu, Kaltrina Thaçi, Ardita Byçi Jakupi, Denis Dalladaku, nga BKK: Fazli Gajraku; CHWB: Sali Shoshi; MKRS: Drenusha Behluli; QRTK: Samir Hoxha.

Udhëheqës dhe kuratorë: Florina Jerliu, Arsim Canolli, Tahir Latifi dhe Arbër Zenuni.



Botimi i 10 vëllimeve të: “Kujtesa e Kosovës: rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe”

Në vitin 2020, Biblioteka Kombëtare e Kosovës, në bashkëpunim me profesorët e Departamentit të Antropologjisë, Arsim Canolli, Tahir Latifi dhe Shemsi Krasniqi (Sociologji), hartoi projektin e mbledhjes së rrëfimeve të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe, të cilin e përkrahu financiarisht Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Projekti mori edhe përkrahjen e Ambasadës Amerikane në Kosovë dhe komunës së Rahovecit. Në fakt, Ambasada Amerikane në Prishtinë qe iniciatore e këtij projekti, pas vizitës në Krushë të Madhe të ambasadorit Philip Kosnett dhe gruas së tij Alison Kosnett, në verë të vitit 2019. Projekti u menaxhua nga Gresa Maliqi nga BKK dhe u realizua në bashkëpunim me stafin e BKK-së. Ata janë Fazli Gajraku, Rudina Tahiraj, Liridon Zekaj, Albanë Morina dhe dy punëtorët e palodhshëm, kameramanët, xhiruesit e videointervistave Valdet Hoti dhe Bujar Mehmeti

Në pranverë të vitit 2021 u rekrutuan 33 hulumtues të cilët u trajnuan nga mentorët e projektit, prof. Arsim Canolli, prof. Tahir Latifi dhe prof. Shemsi Krasniqi. Po ashtu, janë mbajtur trajnime specifike mbi metodologjinë e projektit, nga prof. Aliriza Arënliu nga Departamenti i Psikologjisë dhe prof. Amy Starechesky nga SHBA, Gresa Maliqi dhe Rudinë Tahiraj BKK.

Hulumtuesit/ hulumtuesit në këtë projekt ishin: Agron Canolli, Albionë Selmanaj, Arditë Aliu, Argjira Ukimeri, Arlinda Kqiku, Artinesa Sylmetaj, Besnik Pajaziti, Blerina Rexhaj Bytyqi, Bukuriye Haxhiu, Çlirimtare Januzaj, Drenica Bytyqi,



Edona Ferati, Egzona Azemi, Endrit Temaj, Eronida Ismajli, Fitore Simnica, Flaka Berisha, Gentiana Gallapeni, Greta Avdyli, Halim Kafexholli, Krenare Buzhala, Marigona Dubovci, Mjedra Bajraktari, Qendresa Byci, Qëndresa Hyseni, Ridona Berisha, Shqipdona Ademi, Valdrin Rrahmani, Valentina Krasniqi, Valtrim Hasani, Vasvije Morina dhe Zeliye Krasniqi.

Puna në terren ka filluar në gusht të vitit 2021. Prej 1 gushtit të vitit 2021, deri më 4 gusht të vitit 2022, janë realizuar 200 intervista me të mbijetuarit e masakrës së Krushës së Madhe, shumica prej të cilëve kanë qenë në fshat gjatë kohës së masakrës, kanë shpëtuar duke u fshehur ose kanë ikur në një fshat të afërm.

Më 25 mars 2024, në hollin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, u promovuan 10 vëllimet e këtij projekti dokumentues, me 200 intervistat e të mbijetuarve dhe dëshmitarëve të masakrës së Krushës së Madhe.

Të dy projektet janë të ndërlidhura, të “shkrira” në funksionin të dokumentimit të Kujtesës atocitare, kujtesës së errët/të masakrave dhe më datë 26 mars 2024 u monumentalizuan me hapjen e muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.

Prandaj, faleminderit pafund krushjanëve, Selami Hoti, Berat Duraku, Fahrije Hoti, Artan Zenuni, Sejfullah Sejfullahu, Emire Duraku, Muharem Hoti, Irfon Ramadani, Nehat Duraku, Berat Hoti, Xhevdet Krasniqi, dy imamët e Krushës së Madhe - Halit Shala dhe Isak Rexhepi, pronarët e kafeterisë Mulliri – Bekim dhe Mevlyde Hoti, zyrtaren e Bibliotekës së Krushës së Madhe – Granita Hoti-Behra. Studentët/hulumtuesit dhe profesorët Departamentit të Antropologjisë, Fakultetit të Arkitekturës, BKK-në, MKRS-në, Komunën e Rahovecit, Ambasadën Amerikane në Prishtinë dhe gjithë ata/ato që kanë kontribuar në realizimin e këtyre dy projekteve monumentale!

Etnografi - terren

Arka e Zymit



Më 4 nëntor 2023, Departamenti i Antropologjisë realizoi një vizitë në Has të Prizrenit, në kuadër të së cilës mori pjesë në hapjen e ekspozitës “Arka e Zymit: koleksioni i veshjeve hasjane” të koleksionistes Lajde Kolgjerajt. Gjatë dy ditëve, në kuadër të “Shkollës Verore të Antropologjisë 2023”, studentët e antropologjisë kanë përkrahur znj. Kolgjeraj në inventarizimin e koleksionit të saj, që arrin shifrën prej 843 njësive. Në emër të profesorëve dhe studentëve, ekspozitën dhe punën e znj. Kolgjeraj e përshëndetën prof. Zanita Halimi dhe studentja Miridonë Sylja. Shembulli i familjes Kolgjeraj, njëherësh edhe udhëheqëse e ansamblit kulturor “Katarina Josipi” është ndër shembujt më të mirë të bashkëpunimit të Departamentit të Antropologjisë dhe koleksionistëve privatë në Kosovë.



Darka e lamës 2023



Po ashtu, grupi nga Departamenti mori pjesë në manifestimin “Darka e lamës, darka e bereqetit hasjan” në Gjonaj të Hasit, organizuar nga shoqëria kulturore “Malësori”. Ky qe manifestimi i parë rivitalizues i “Darkës së lamës” që në Has njihet edhe si “Darka e bereqetit”. Pati një performancë speciale nga shoqëria kulturore “Malësori”, si nga ana kulinare ashtu edhe nga ajo artistike. Hasjanët nxorrën në pah mjeshtërinë e tyre të veçantë për të promovuar gatimet tradicionale të zonës. Duhet theksuar se SHKA “Malësori”, që organizon festivalin folklorik “Hasi jehon” dhe herë pas here edhe manifestime të tilla lokale, gjithmonë ka ofruar mundësi për Departamentin e Antropologjisë, duke ua hapur dyert stafit e studentëve për studime për jetën, sjelljen, kulturën e trashëgiminë kulturore në atë zonë.

Falënderojmë znj. Arbnora Kolgjeraj-Rexhajn dhe z. Haziz Hodajn për përkrahjen e këtij udhëtimi për stafin dhe studentët e Departamentit të Antropologjisë!

Shkolla Verore e Antropologjisë 2024



Shkolla Verore e Antropologjisë (SHVA) organizohet nga Departamenti i Antropologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”. Këtë vit, SHVA u organizua në bashkëpunim me Muzeun e Ferizajit dhe organizatën joqeveritare për trashëgimi kulturore

THANA, në Ferizaj.

SHVA është realizuar si shkollë praktike që në fokus ka trajnimin praktik të studentëve nëhulumtimi, evaluimin dhe dokumentimin e trashëgimisë kulturore në muze, duke u fokusuar në Muzeun e Ferizajit.

Për 5 ditë me radhë, SHVA ka organizuar 5 ligjërata tematike, me temë bosht “Muzeu dhe qyteti”, për të hapur diktutimin mbi rëndësinë, peshën, nevojën dhe mundësitë që ofron muzeu i qytetit për qytetarët dhe komunitetet e ndryshme në qytet.

1. Ligjërata e z. Ilir Bytyçit, “Trashëgimia kulturore e Ferizajt dhe Muzeu”
2. Ligjërata e prof. Arsim Canollit, “Muzeu i qytetit në

Kosovë: gjendja, sfidat dhe mundësitë”

3. Ligjërata e ass. Dr. Ilir Culajt “Rrëfimi arkeologjik në muze”
4. Ligjërata e Aranit Krasniqit (THANA) “Kërkimi arkivor dhe muzeu”
5. Ligjërata e prof. Zanita Halimit “Muzeu si shkollë e trashëgimisë kulturore”

Në SHVA morën pjesë 5 profesorë të Departamentit të Antropologjisë, zyrtari i Muzeut të Ferizajit dhe një përfaqësues nga organizata THANA. Po ashtu, u rekrutuan 10 studentë të Departamentit të Antropologjisë, FF/ UP dhe Fakultetit të Arkitekturës UP. SHVA zgjati prej 8 deri më 12 korrik dhe u mbajt në Muzeun e Ferizajit.

Qëllimi kryesor i SHVA-së ka qenë trajnimi praktik i studentëve në evaluimin e institucionit të muzet të qytetit dhe në inventarizimin e artefektave muzeore. Gjatë SHVA-së janë mbajtur 5 ligjërata



dhe 10 punëtori praktike ku pjesëmarrësit kanë kryer vrojtime, hulumtime, inventarizimi, SWOT analiza, etj. Gjatë këtyre punësive praktike është realizuar gjithë hulumtimi për të ardhur deri te gjetjet kryesore.

Po ashtu, janë realizuar 100 pyetësorë bazikë me qytetarë të Ferizajt dhe janë inventarizuar, në mënyrë bazike, 101 artefakte të muzeut, për të krijuar një model për të vazhduar në të ardhmen me gjithë koleksionin muzeor, nga vetë Muzeu i Ferizajt. Po ashtu është realizuar një intervistë me z. Ilir Bytyqi dhe është bërë një SWOT analizë e bazuar në fokus grupe për të identifikuar përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e muzeut.

Pas mbatjetes së SHVA-së është shkruar një raport i gjerë që përmbledh punën e përgjithshme të SHVA-së, duke nxjerr në pah gjetjet kryesore dhe ofruar rekomandime që dalin nga kjo shkollë. Raporti është dorëzuar te Muzeu i Ferizajt dhe mund të shfrytëzohet nga muzeu, komuna, organizatatat joqeveritare lokale, bizneset lokale, artistët e qytetarët e ndryshëm për të përmirësuar gjendjen në Muzeun e Ferizajt.



Përvojë unike në Lubjanë

Semestrin e kaluar, si bursist i programit Erasmus+, e kalova në Universitetin e Lubjanë në Slloveni. Eksperienca ka qenë vërtet unike dhe ka pasur një efekt pozitiv në zhvillimin tim si student.

Vet arritja në aeroportin e Ljubljanes ishte një përvojë e veçantë sepse edhe në kaosin e procedurave dhe kontrollit në aeroport, brenda një kohe aq të shkurtër, mund të shihje diferencat kulturore mes aeroportit të Prishtinës “Adem Jashari” dhe aeroportit të Lubjanës “Jože Pučnik”.

Me qenë se unë kisha statusin e studentit ndjeja një mirëpritje nga stafi i aeroportit, një mikpritje që do të përcaktonte disponimin se si unë do të ndihesha në vijim në Lubjanë. Arritja në stacionin e autobusit në Lubjanë dhe gjetja e hotelit ku do të qëndroja për ditët e para është e paharrueshme. Për disa momente qyteti i Lubjanës i cili nuk është

më i madhë se qyteti i Prishtinës të duket si një botë tjetër ku rrugët e ndryshme ofrojnë mundësi të paimagjinueshme të vendeve ku mund ta gjesh veten.

Vendosja në konvikt ishte një shok kulturor për mua ngaqë unë nuk kisha jetuar në konvikt më herët. Takimi me cimerët ishte poashtu një eksperiencë e jashtëzakonshme sepse është vërtet interesante të shohësh se si njerëzit e vendeve të tjera mendojnë për ty, çka dinë për ty dhe për vendin nga vjen ti. Ballafaqimi me tjetrin është qëllimi kryesor i programit Erasmus+ ku gjatë një bashkëjetese pesë mujore e kupton se sa të ndryshëm dhe sa të përafërt jemi. E shoh se ne kemi ruajtur shumë vlera që të tjerët i kanë harruar tashmë, por e shoh poashtu se gjejmë shumë vlera tjera tek të tjerët që neve na duhen.


Eksperienca në fakultet ishte përvoja më interesante dhe më e

dobishme edhe pse në fillim kishte pak probleme me koordinimin e lëndëve. Tradita akademike nënkupton një traditë të leximit dhe studimit të teksteve të caktuara. Lubjana është mjaft e pasur sa i përket kësaj tradite dhe mënyra e përzgjedhjes së literaturës është e ndryshme nga ajo në Prishtinë. Kjo të bën të vësh në pikëpyetje edhe ato koncepte që deri sot ti i konsideroj si “common sense”. Edhe komunikimi me kolegët dhe profesorët, edhe metodologjia e vlerësimit dhe jeta e organizuar kulturore e universitare në Ljubljane e pasuruan këtë përvojë.

Qëllimi i këtij shkrimi është të bëj apel që studentët të marrin pjesë në programin Erasmus+ ngaqë ballafaqimi me ambientin e huaj të mundëson që të zbulosh më shumë për vetendhe vendin tënd dhe të mësosh për tjetrin.

Edhe një botim i ri nga stafi i Departamentit

Në fund të vitit 2023, u botua Enciklopedia e Evropës, me titull: *Europe: An Encyclopedia of Culture and Society*. Zëri për Kosovën është shkruar nga antropologët/et Tahir Latifi dhe Zanita Halimi



ULPIANAFEST 2024



Për 3 netë me radhë, më 31 gusht dhe 1 shtator 2024, në Parkun Arkeologjik të Ulpianës u mbajt festivali arkeologjik ULPIANAFEST, edicioni i dytë me radhë, organizuar nga Rilinda Gjonbalaj, studente dhe Ilir Culaj, asistent, dhe studentët e Departamentit. Në festival u prezantua arkeologjia dhe trashëgimia kulturore, përmes ekspozitave, këndit arkeologjik, këndit të periudhës antike, këndit të poçarisë, këndit të numizmatikës, këndit të hajeve të vjetra, këndit të djathit të Sharrit – që ishte shumë i famshëm në antikë – këndit të lojërave në antikitet, shigjetaria, këndit të pikturë e shumë të tjera. Po ashtu, u dha shfaqja teatrale “Ora et Labora” për dy martirët e krishterimit, shën Florin dhe Laurin e realizuar me me skenar e regji enkas për këtë festival. Festivalin e vizituan shumë vizitorë, prej më të rinjve të diplomatët. Në festivali u dhanë mirënjohje për Ambasadën Amerikane, Ambasadën Franceze dhe Bashkimin Evropian, për kontributin e tyre në arkeologji e trashëgimi kulturore të Ksoovës.

Po ashtu gjatë festivalit u mbajt dhe ARKEOKAMPI, ku morën pjesë studentë nga diaspora e nga Kosova të cilët dëgjuan ligjërata nga profesorët dhe morën pjesë në festival, por edhe vizituan vende të trashëgimisë kulturore në Kosovë.



SEMINARI

Auraliteti dhe etnomuzikologjia



Sivjet, Seminari i antropologjisë, ka temë bosht “trashëgiminë kulturore”. Më 26 tetor 2023, u mbajt ligjërata e parë nga Prof. Asoc. Dr. Mikaela Minga, etnomuzikologe dhe antropologe e muzikës, njëherish edhe përgjegjëse e Departamentit të Folklorit në Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë.

Përmes ligjëratës me temë “Auraliteti dhe etnomuzikologjia në Shqipëri: Regjistrimet zanore të Elbasanit si rast studimi”, Mikaela hapi diskutimin për muzikën popullore të regjistruar gjatë komunizmit në Shqipëri, duke marrë rastin e Elbasanit. Kjo temë del nga studimi i saj shumëvjeçar i këngëve dhe teksteve të regjistruara gjatë komunizmit dhe të ruajtura në arkivat e Institutit të Antropologjisë Kulturore, nga kërkimi në terren në “kërkim” të këngëtarëve dhe hisedarëve të tjerë të prodhimit / incizimit të këngëve dhe nga diskutimi teorik e historik mbi auralitetin, oralitetin dhe literaritetin, në kontekst të kohës së prodhimit të tyre, por edhe të prodhimit të dijes etnomuzikologjike të kohës. Si është dehumanizuar kënga e tingull? Si procesohet kënga nëpër aktin e mbledhjes e arkivimit?

Gjatë ligjëratës, Dr. Minga ofroi shembuj nga konteksti historik i peizazhit tingullor në modernitetin shqiptar të gjysmës së dytë të shekullit 20, në kushtet e diktatit komunist, duke shoshitur lëndën e saj nëpër një sërë teorish bashkëkohore etnomuzikologjike dhe antropologjike, me fokusin kryesor të “kthesa aurale” (aural turn). Rezultatet e studimit të saj jepen gjerësisht në librin e saj “Tinguj që rrefejnë, tinguj që rrëfehen: Elbasani në regjistrimet etnomuzikologjike të arkivit audiovizual -IKSA” (ASA, 2020, Tiranë). Libri synon të shoh se çfarë raportesh ka krijuar shteti, përmes etnomuzikologjisë si praktikë e kontrolluar etatiste, me peizazhin tingullor që ka ekzistuar në jetën sociale në qytet e fshat.

Ligjërata ofroi një rast studimor për të parë efektin e diktaturës komuniste mbi gjithë landshepin tingullor në Shqipëri.

Sa më pak ndërhyrje burokratike/ institucionalizuese në trashëgiminë kulturore shpirtërore



Më 30 nëntor 2023, në Seminarin e Antropologjisë, ligjëroi prof. Regina Bendix nga Universiteti i Gyttingenit (Göttingen) nga Gjermania, me temë “Trashëgimia shpirtërore: dija, përvoja dhe vlera e pabarabartë”. Në pamundësi të udhëtonte, prof. Bendix mbajti ligjëratën në mënyrë virtuale.

Prof. Bendix foli për trashëgimimizimin si proces që ka filluar kryesisht me miratimin e konventës së UNESCO-s për trashëgimi kulturore shpirtërore (2003) dhe racionalizimin e tepruar të shteteve anëtare, në drejtim të “krijimit të trashëgimisë”, por edhe burokratizimit të mbrojtjes e ruajtjes.

Trashëgimia materiale dhe shpirtërore dallojnë dhe nuk mund të trajtohen njësoj. Po ashtu, secila trashëgimi materiale nuk është trashëgimi pa dijen dhe kujtesën që e rrethon. Ajo nuk duhet të mbrohet e ruhet sikurse trashëgimia materiale. Ka tjetër karakter. Prandaj, ekziston një pabarazi në trajtimin e këtyre kategorive. Nga ana tjetër, edhe pas miratimit të konventës së UNESCO-s, kemi po ashtu një lloj gare nga shtetet anëtare, ku prijnë ato perëndimore, në futjen në listë apo “listimin” e praktikave të ndryshme në UNESCO. Prej praktikës së zakonshme gjërat bëhen trashëgimi kulturore shpirtërore.

Prof. Bendix argumentoi se procesi institucionalizues e racionalizues i “krijimit të trashëgimisë”, mund të jetë i dëmshëm për vetë trashëgiminë kulturore shpirtërore. Këto dëme apo rreziqe vijnë nga gara etnike, komercializmi dhe byrokratizimi. Sipas saj, “praktika është më e rëndësishme se sa trashëgimimizimi”. Pra, Prof. Bendix, sikurse edhe në shkrimet e saj akademike, propozoi praktikën dhe vazhdimin e përmirësimit të dijes kulturore e shpirtërore përkundër trashëgimimizimit të dijes, sepse shpeshherë “trashëgimimizimi” krijon edhe idenë e “muzealizimit”. Dhe, ky proces, në anën tjetër, mund të bëhet një lloj pengese në vazhdimin, përmirësimin dhe rivitalizimin e dijes. Por, ka raste, e këtu kemi raste edhe nga Kosova, trashëgimimizimi apo edhe “futja në listë të trashëgimisë kulturore të shtetit” mund të bëhet edhe shkas për rivitalizim dhe vazhdimësi. Pra, rëndësia e trashëgimimizimit varet nga konteksti.

Prof. Bendix njihet për qasjen e saj kritike ndaj idesë së “autenticitetit” e “monumentalitetit”. Libri i saj i fundit, mes tjerash, “Culture and value” (Indiana University Press, 2018) diskuton edhe këto çështje. Ligjërat e saj ishte një freski kritike në diskutimin e vazhdueshëm në Departamentin e Antropologjisë, se kah po ecën “trashëgimimizimi” si proces i ruajtjes, mbrojtjes, promovimit dhe aspekteve të tjera.

Veshjet, moda dhe dizajni i modës



Më 14 dhjetor 2023, Profesori Adam Drazin, nga Departamenti i Antropologjisë, University College London, diskutoi për antropologjinë e modës, dizajnit dhe teknologjisë inovative në krijimin e artefakteve të reja të modës në fushën e modës dhe industrisë së tekstilit.

Ai foli për kuptimin e artefaktit digjital të modës në kontekst të industrisë së modës dhe prodhimit të veshjeve, në kontekst global, duke marrë shembuj nga studimi i tij në Rumani dhe nga projektet e shumta në Kolegjin e Modës në Londër.

Çfarë peshe ka studimi etnografik i funksionit, estetikës e biznesit në industri të modës? Sa zë vend “moda digjitale” në kontekst të modës në “high street”, veshjeve të dorës së dytë, modës së riciklueshme dhe ekologjike? Si kuptohet “me i provue teshat” në avatarin tënd digjital para se t’i blesh ato? Sa ka peshë ndjenja sensoriale e “teshit” në trup e sa ka peshë vetëm provimi i saj në avatarin tuaj digjital? Çfarë mbetet për muzetë për të ruajtur si veshje autentike?

Këto e shumë pyetje të tjera, orientuan ligjëratën dhe diskutimin me studentët, dizajnerët e modës dhe ligjëruesit e Departamentit të Antropologjisë.

Trashëgimia kulturore – ku e lamë ku na mbeti?



Më 15 janar 2024, profesorjesha Florina Jerliu nga Fakulteti i Arkitekturës, mbajti ligjëratën e saj, “Vazhdimësia dhe ndryshimet si përgjigje ndaj sfidave të konservimit dhe restaurimit” në kuadër të Seminarit të Antropologjisë.

Ajo foli gjerë për proceset resauruse dhe konzervuese në Kosovë, duke marrë shemujt të shumtë nga trashëgimia kulturore ndërtimore. Sfidat e ndërhyrje dhe resturimit janë po aq të mëdha sa edhe sfidat e vetëdijesimit dhe menaxhimit të aseteve të trashëgimisë kulturore. Prof. Jerliu diskutoi për qendrat urbane e qendrat historike dhe nevojën e zhvillimit gjithnjë në kontekst të ruajtjes.

Prof. Jerliu ofroi edhe shembuj të projekteve të realizuara nga Fakulteti i Arkitekturës që nga vitit 2004, me Unikun e deri te trashëgimia industriale e Trepçës, ku ka bashkëpunuar me Departamentin e Antropologjisë, në ruajtjen dhe promovimin e kujtesës së Trepçës.

Prof. Jerliu shpalosi edhe projekte të tjera ku është punuar me kujds dhe finsesë dhe raste ku ka pasur edhe dëmtime të trashëgimisë kulturore. Ligjërata e saj zgjoi interesim të madh në mesin e studentëve dhe kolegëve dhe pati një sërë pyetjesh.

Fotografia dhe trashëgimia



Më 29 shkurt 2024, profesoresha Zanita Halimi nga Departamenti i Antropologjisë, mbajti ligjëratën e saj , “Ruajtja e trashëgimisë kulturore përmes fotografisë familjare” në kuadër të Seminarit të Antropologjisë.

Në kuadër të kësaj ligjërata, prof. Halimi ofroi një pasqyrë teorike dhe empirike të temës së saj, të cilën e kishte pasur edhe pjesë të studimeve doktorale. Fotografia familjare është një temë më se e studiuar në antropologjinë kulturore, por ka pak studime të kësaj natyre në ato shqiptare. Ligjërata tregoi arsyet e studimit historik dhe antropologjik të fotografisë, mënyrat se si vshtë zhvilluar fotografia familjare në Kosovë, ndryshimet dhe transformimet në procesin e krijimit dhe konsumit të fotografisë familjare, ritet, praktikat, festat dhe aspekte e tjera sociale, politike e ekonomike që ndërlidhen me fotografinë familjare.

Prof. Halimi reflektoi edhe mbi metodat dhe perspektivat e saj mbi fotografinë familjare në Kosovë dhe tematikat tjera që etnografia e fotografisë materiale nxjerr në pah.

Ligjërata hapi një debat të bujshëm mbi mënyrat e ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore përmes fotografisë, por edhe vet fotografisë si trashëgimi kulturore.

Oral-History.Digital: Një platformë për arkivimin, kurimin dhe prezantimin e intervistave biografike



Më 28 mars 2024, Dr.Cord Pagenstecher, nga Freie Universitat Berlin, mbajti një ligjëratë në Seminarin e Antropologjisë, ku shfaqti platformën Oral-History.Digital në Universitetin Freie të Berlinit. Dr. Pagenstecher rrëfeu për rolin e historisë gojore në sudimet antropologjike dhe sfidat e realizimit të projekteve të historisë gojore, që nga aspekti etike deri te ai teknik.

U morën disa shembuj të projekteve të ndryshme në të cilat ka punuar Dr. Pagenstecher dhe u dhanë disa rekomandime se si mund të arkivohen, kurohen dhe të prezantohen para publikut intervistat e ndryshme autobiografike. Po ashtu u fol për rëndësinë e transkriptimit të intervistave në formën sa më të mirë dhe ofrimin e tyre si dokumente publike për të gjithë për t' i lexuar.

Në këtë kontekst, u diskutua edhe për aspektet etike e ligjore dhe të drejtat e autorit në intervistat e historisë gojore, ku autorë janë edhe intervistuesi edhe i intervistuari. Pas ligjëratës pasoi një diskutim i gjatë mes Dr. Pagenstecher-it dhe studentëve e stafit të Departamentit të Antropologjisë dhe mysafirëve të tjerë nga departamentet e tjera dhe organizatat joqeveritare që merren me histori gojore.

Trashëgimia kulturore është nevojë fundamentale njerëzore



Më 25 prill 2024, në Seminarin e Antropologjisë prezantoi antropologia prof. Angela Labrador-, nga Johns Hopkins University (SHBA). Ajo diskutoi për mënyrat se si antropologjia mund të kontribuojë në edukimin mbi trashëgiminë kulturore. Mbi të gjitha, prof. Labrador cilësoi modeli antropologjik të studimit të trashëgimisë kulturore si model i praktikave sociale që ndërlidhin identitetet tona në kohë dhe hapësirë. Kësisoj, ajo erdhi në përfundim se trashëgimia kulturore është “nevojë thelbësore njerëzore” (fundamental human need). Vetëm antropologjia mund ta mishërojë këtë nevojë në mënyrë të shëndetshme në shoqëri, sepse e promovon vlerën e identitetit të veçantë në kuadër të diversitetit kulturor.

Sipas saj, antropologjia është e lidhur si me kërthizë me trashëgiminë kulturore dhe përmes studimit antropologjik mund të njihen vlerat e trashëgimisë kulturore dhe të prioritetizohet qasja humane e shpirtërore, qasja kujtesore e identitare, ndaj trashëgimisë kulturore.

Pse trashëgimia kulturore ka nevojë për antropologjinë? Si mund të kontribuojnë antropologët? Çfarë do të thotë kjo për edukimin mbi trashëgiminë? Këto qenë tri pyetjet kryesore të cilat qenë në qendër të ligjëratës së saj, për të diskutuar përmes shembujve të përzgjedhur.

Prof. Labrador tha: “We can understand heritage as practices in the present that reference the past to shape the future. That is my definition of heritage.” [Trashëgiminë mund ta kuptojmë si praktikë e të sotmes, e cila i referohet të kaluarës, për t’i dhënë kahje e formë të ardhmes. Ky është përkufizimi im i trashëgimisë.]

Prof. Angela Labrador është redaktore e librit “The Oxford Handbook of Public Heritage Method and Theory, 2018” botuar nga Oxford University Press.

Dardania (Kosova) gjatë periudhës së hekurit



Në ligjëratën e Seminarit të Antropologjisë, të mbajtur më 23 maj 2024, në Departamentin e Antropologjisë, Dr. Premtim Alaj, nga Instituti Arkeologjik i Kosovës, nxori në pah hulumtimet e tij arkeologjike mbi kohën e hekurit në Dardaninë antike, me fokus në territorin e Kosovës së sotme. Dr. Alaj ka mbrojtur doktoratën në arkeologji në Universitetin Lyon 2, në Francë, me temën mbi vendbanimet e kohës së hekurit në Dardani (Kosovë). Ai ka shkruar një mori artikujsh në revista dhe është në përfundim të një monografie arkeologjike mbi kulturën funerare të epokës së hekurit.

Gjatë ligjëratës, Dr. Alaj ofroi një kallxor tematik të shenjave të vendbanimeve, praktikave funerare dhe kulturës materiale, të periudhës së hekurit, të cilat i shtjelloi edhe në kontekst të formimit e zhvillimit të kulturës dardane. Gërmimet kryesore të Dr. Alajt janë realizuar në Cërrnicë të Gjilanit, por edhe në vendet të tjera si Dollc e Lubozhdë. Ndërsa në interpretimin e tij ai shqyrtoi gjithë evidencat e gërmimeve dhe interpretimeve arkeologjike të realizuara në Kosovë.

Theksi i ligjëratës u vendos te:

- Tipologjia dhe periodizimi i vendbanimeve të kohës së hekurit
- Mungesa e evidencës materiale për shkak të mbindërimit, sidomos në vendbanimet kodrinore
- Raporti mes vendbanimeve kodrinore, terracore dhe fushore, që ndërlidhet edhe me aspektet shoqërore, politike, ushtarake e ekonomike
- Shumësia e shtresave të lokaliteteve (prej neolit deri te antikiteti i vonë, shumë prej tyre)
- Mungesa e evidencave të deritanishme të vendbanimeve dardane me perimetri të plotë
- Evidenca e një kulture materiale të pasur në vendbanimet terracore
- Dekorimet e enëve, sipas një teknike vendëse

Ekzistojnë afër 100 lokalitete të ndryshme ku janë gjetur evidenca nga koha e hekurit dhe sipas matjeve ato përbëjnë rreth 80 hektarë. Por, me gjasë ka shumë më shumë vendbanime dhe ato janë më të mëdha se sa janë menduar. Gjatë diskutimit me kolegë e pjesëmarrës u hapën edhe tema të shtrirjes gjeografike, raportit të vendbanimeve me fortifikimet përreth, jetës ekonomike, tregtisë e shumë aspekte të tjera.

Kjo ishte ligjërata e fundit e këtij viti akademik, me temë bosht “Trashëgimia kulturore”. Seminari i Antropologjisë rikthehet në vjeshtë, në vitin e tij të 6-të, me ligjërata nga tema bosht “Ritet dhe praktikat rituale”.

Konferenca e INASEA-s në Prishtinë



Nga 19 deri 22 shtator 2024, në Departamentin e Antropologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës, u mbajt konferenca e 11-të e InASEA. Më shumë se 100 studiues nga vende të ndryshme të Evropës prezantuan studimet e tyre në Prishtinë. Tema e konferencës: “In, out and in between. Transnational and internal migration in Southeast Europe”.

Kishte mjaft për t’u thënë, diskutuar, e debatuar. Shumë pyetje u bënë për dhe nga studiuesit pjesëmarrës, shumë përgjigje u dhanë, të tjera pyetje mbesin të hapura, duke u plotësuar e përditësuar në studimet e reja.

Kjo konferencë ishte një mundësi shumë e mirë edhe për studentët e Fakultetit Filozofik, të cilët ishin të numërt me pjesëmarrje dhe shumë aktiv me pyetje e komente dhe bashkëbisedim me studiues nga të gjitha vendet e Evropës. Shpresojmë që t’u hapë mundësi të reja studimesh dhe bashkëpunimi.

Falënderojmë të gjithë ata që mundësuan organizimin e kësaj konference:

Universiteti i Prishtinës, rektorin profesor Qerim Qerimi bashkë me prorektorët/et

Zyra për Marrëdhënie me Jashtë e Universitetit të Prishtinës

Fakulteti Filozofik, dekanin profesor Dashmir Bërxulli, bashkë me prodekanët, veçanërisht profesor Muhamet Qerimi

Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, zv.ministren, znj. Liza Gashi

Shefen e misionit të IOM-it në Kosovë, znj. Anna Rostocka

Komunën e Rahovecit dhe Stone Castle Vineyard and Winery

Bordin e InASEA.

Për fund, falënderojmë kolegët dhe studentët e Departamentit të Antropologjisë – pafundësisht krenarë!



Departamenti i Antropologjisë

Me: 16 profesorë, ligjërues e asistentë, dhjetëra studentë (përfshirë alumni), 30 partnerë vendorë e ndërkombëtarë, 2 laboratorë të trashëgimisë kulturore, 8 projekte të historisë orale, 4 projekte arkeologjike, 6 projekte hulumtuese antropologjike

boton: revistën shkencore "Kosova anthropologica" libra universitarë, monografi e punime shkencore, vjetarin AA dhe doracakun për studentë

organizon: Seminarin e Antropologjisë, tryeza shkencore, punëtori profesionale, shkollë verore antropologjike, vizita studimore

ofron ekspertizë për: Ministrinë e Kulturës institucionet qendrore të artit, kulturës e trashëgimisë kulturore, Muzetë, organizatat e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, mediet lokale e rajonale, produksionet

bashkëpunon dhe menaxhon: projekte të gërmimeve arkeologjike, restaurime të objekteve të trashëgimisë kulturore, dokumentimit të trashëgimisë shpirtërore, dokumentimit të artit dhe kulturës alternative, projekte të interpretimit të sjelljes në shoqëri

Vizito e shfletu

Departamenti i Antropologjisë.
Fakulteti Filozofik / UP

Për më shumë vizito uebfaqen tonë

<https://filozofiku.uni-pr.edu/>

te "Departamentet" zgjedh
"Departamenti i Antropologjisë"

Facebook: Departamenti i Antropologjisë / UP



BA

Antropologji dhe trashëgimi kulturore

Lëndë në gjuhën shqipe dhe angleze
Mundësi për një semestër jashtë vendit
Përfshirje në projekte e punë praktike



Departamenti i Antropologjisë
Fakulteti Filozofik / UP

Vizioni e misioni

Si student i antropologjisë dhe trashëgimisë kulturore, do të mësoni për traditat, zakonet, artefaktet dhe monumentet që përcaktojnë trashëgiminë dhe identitetin tonë të përbashkët.

Nga qytetërimet e lashta deri të komunitet modern, antropologjia / trashëgimia kulturore na ofron një dritare në të kaluarën dhe një themel për të ardhmen.

Mendjehapur për mendje të hapur në shoqëri. Bashkohuni me ne në rrugëtimin e zbulimit të kompleksitetit të kulturave!

Programi i studimit

Program ku mund të studiosh antropologji të kulturës, shoqërisë e trashëgimisë kulturore.

* Programi ofron lëndë zgjedhore edhe në gjuhën angleze. Shih uebfaqen për më shumë!

Përfshirje e partneritete

Departamenti u ofron studentëve edhe:

- përfshirje në projekte vendore e ndërkombëtare
- mundësi për shkollë verore antropologjike
- trajnime në fusha specifike
- vizita studimore vjetore
- mundësi për punë praktike në institucione
- aftësi për dizajn dhe menaxhim të projekteve kulturore
- mundësi studimi semestral në universitetet partnere në Evropë



Tematika e studimeve

- Antropologji kulturore
- Arkeologji dhe histori e qytetërimeve
- Histori e artit
- Mbrojtja, ruajtja e menaxhimi i trashëgimisë kulturore
- Identiteti social e kulturor
- Antropologji urbane dhe gjinore
- Filmi etnografik
- Familja, migrimi, kultura urbane
- Arkeologjia e Kosovës
- Etnologjia shqiptare
- Festat, ritet dhe festivalet
- Etnolinguistikë
- Kujtesa kolektive dhe histori orale
- Mediet dhe kultura digjitale
- Muzeu dhe ekspozimi i kulturës
- Teoria, kërkimi dhe shkrimi antropologjik
- Ekokultura, mjedisi dhe natyra
- Turizmi kulturor
- Dizajnimi i projekteve kulturore





SEMINARI I ANTROPOLOGJISË

Departamenti i Antropologjisë
Fakulteti Filozofik | Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Agjenda për vitin akademik 2024/2025
Tema bosht: Ritet dhe praktikat rituale

24.10.2024

Prof. Ass. Dr. Sedat Baraliu,
Departamenti i Antropologjisë, UP

Tema

Djegia si rit i varrimit tek dardanët gjatë periudhës së hekurit

14.11.2024

Prof. Dr. Marijana Belaj,
Universiteti i Zagrebit, Kroaci

Rituals, politics and sacralization of places

05.12.2024

Prof. Dr. William Van Andringa,
École Pratique des Hautes Études, Paris, Francë

The archaeology of gest: rites and ritual practices in Pompeii

30.01.2025

Prof. Dr. Ledi Shamku Shkreli,
Instituti i Antropologjisë, ASHSH, Tiranë

Riti arbëresh i qerreve

27.02.2025

Prof. Dr. Lumnije Kadriu,
Instituti Albanologjik i Prishtinës

Pushimet e mërgimtarëve në kontekst të ritualitet dhe riteve

28.03.2025

Dr. Ilir Culaj
Departamenti i Antropologjisë, UP

Nga ritet religjioze te praktikat politike në botën romake: rasti i kolegjit të Ogurëve

24.04.2025

Prof. Dr. Belisa Muka
Instituti i Arkeologjisë, ASHSH, Tiranë

Arkeologjia mortore: sfida dhe perspektiva në studimin e jetës nëpërmjet vdekjes

29.05.2025

Prof. Dr. Olsi Lelaj
Instituti i Antropologjisë, ASHSH, Tiranë

Në ndërmjetësi: Ritet e kalimit dhe moderniteti i planifikuar

Vendi: Fakulteti Filozofik, salla nr. 127
Ora 16:00